



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.05.2023

Nr: 142

Ora: 14:10

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 80, DATË 23.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri

**PALË E INTERESUAR:** Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi

**OBJEKT:** 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Rrogozhinë" dhe miratimi i Tabelës së Re Përmbledhëse pas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore bashkia Rrogozhinë.



2. Kundërshtimin e vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Rrogozhinë” dhe miratimi i Tabelës së Re Përmbledhëse duke hequr rezultatin zgjedhor të qendrës së votimit nr. 2224/1, IEVP Rrogozhinë.

3. Shpalljen fitues për kryetar të bashkisë Rrogozhinë z. Shkëlqim Hamid Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë”.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 80 regj., datë 23.05.2023.

Në mbledhjen e datës 25.05.2023, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 80 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 80, datë 23.05.2023, të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 31.05.2023, ora 13:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>